



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1214
Data e Vendimit: 23.12.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 7 dhe neni 109 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 17.12.2024 të kërkesës për tërheqje nga ankesa të parashtruar nga OE N.N.P Vllëzërit Sahiti., për tërheqje nga ankesa e parashtruar me datë: 16.12.2024 me nr. 2024/1214 kundër njoftimit për kontrat (B05) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja Dimërore e Rrugëve dhe Trotuareve, Debllokimi i Kanalizimit Atmosferik (heqja e bore, fshirja e mbeturinave dhe larja sipas kushteve) – LOT 7” me numër të prokurimit 616-24-11488-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Kuvendi i Komunës së Prishtinës, Paneli Shqyrtues në përbërje nga Isa Hasani - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi- Anëtare, me 23.12.2024, morën këtë:

Vendim

1. Aprovohet, kërkesa për tërheqjen e ankesës, e datës 17.12.2024, e parashtruar nga N.N.P Vllëzërit Sahiti, me nr. 2024/1214, e datës 16.12.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja Dimërore e Rrugëve dhe Trotuareve, Debllokimi i Kanalizimit Atmosferik (heqja e bore, fshirja e mbeturinave dhe larja sipas kushteve) – LOT 7” me numër të prokurimit 616-24-11488-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës., që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja Dimërore e Rrugëve dhe Trotuareve, Debllokimi i Kanalizimit Atmosferik (heqja e bore, fshirja e mbeturinave dhe larja sipas kushteve) – LOT 7” me numër të prokurimit 616-24-11488-2-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.
3. Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa dhe pretendimet ankimore, duke u bazuar në nenin 31 pika 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës.

Arsyetim

Operatori ekonomik OE N.N.P Vllëzërit Sahiti., me datën 16.12.2024, përmes platformës elektronike ka paraqitur ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja Dimërore e Rrugëve dhe Trotuareve, Debllokimi i Kanalizimit Atmosferik (heqja e bore, fshirja e mbeturinave dhe larja sipas kushteve) – LOT 7” me numër të prokurimit 616-24-11488-2-1-1, inicuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Operatori ekonomik N.N.P Vllëzërit Sahiti., me datën 17.12.2024 përmes platformës elektronike sistemit e-prokurimi është tërhequr nga ankesa, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja Dimërore e Rrugëve dhe Trotuareve, Debllokimi i Kanalizimit Atmosferik (heqja e bore, fshirja e mbeturinave dhe larja sipas kushteve) – LOT 7” me numër të prokurimit 616-24-11488-2-1-1.

Me rastin e informimit lidhur me veprimet e përshkruara si më sipër, Paneli Shqyrtues mori vendim për aprovimin e kërkesës për tërheqje nga ankesa duke i lejuar AK që ta vazhdojë aktivitetin e prokurimit (i përshkruar si më sipër) nëse AK nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet. Krahas kësaj po ashtu duhet theksuar se në të tilla raste mungon efekti pezullues i ankesës në kuptim të nenit 112, paragrafi 1, të LPP sipas të cilit dorëzimi i një ankesë e obligon AK që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret. Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si më sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundoj procedura ankimore në këtë fazë, pa nevojë që të hapet faza e vlerësimit meritior lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, sepse mungon objekti ankimor dhe elementet qenësore të ankesës sipas nenit 111 të LPP;

Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si më sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundoj procedura ankimore para OSHP në këtë fazë dhe lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, për faktin se:

- mungon objekti ankimor dhe elementet qenësore të ankesës sipas nenit 111 të LPP;
- ankuesit, i mungon statusi i palës së interesuar, sipas nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP.

Në këtë rast duhet theksuar se në kuptim të nenit 13, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik. Kurse në kuptim të nenit 109, paragrafi 1, të LPP, po ashtu parashihet se çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Mirëpo, në kuptim të parimeve bazë të legjislacionit, posaçërisht parashikuar me dispozitën e nenit 93 të Ligjit për Procedurën e përgjithshme administrative, kjo njëherësh kjo nënkupton faktin se çdo palë e interesuar ka të drejtë po ashtu ta ndryshoj (plotësoj, përmirësoj, precizoj) ankesën dhe po ashtu ta tërheq atë. Në fakt, Paneli Shqyrtues ka konfirmuar faktin e tërheqjes së ankesës, bazuar në veprimet e palës përmes publikimit të tyre në platformë përkatësisht faqen zyrtare të sistemit të prokurimit publik, prandaj nuk gjeti arsye për të vepruar në kuptim të nenit 110 të LPP andaj janë krijuar kushtet që procedura në këtë çështje juridiko administrative të përfundoj në kuptim të nenit 97 të LPPA.

Megjithatë Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK, në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa dhe pretendimet ankimore, duke u bazuar në nenin 31 pika 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Isa Hasani
U.D Kryetar

€



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES
- OE - N.N.P."VLLËZËRIT SAHITI"
- Arkivës së OSHP-së:

